



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 487/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit Nisma-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr. 487/2019 e datës 16.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik koalicionit Nisma-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 0403X/06D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 16.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.487/2019 nga subjektit politik koalicionit Nisma-AKR-PD, në të cilën pretendohet se më 15.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 0403X/06D është shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim ku shihet se janë votuar dy subjekte politike ai me numrin rendor 112 PDK dhe subjekti politik 119 AAK.

Sipas parashtruesit të ankesës KQZ-ja, ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim në kundërshtim me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së., dhe kërkon që fletëvotimi nga kjo kuti e votimit të shpallet i pavlefshëm.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 17.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se ligji për zgjedhjet thotë se fletëvotimi shpallet i vlefshëm në rast se dihet qëllimi i qartë i votuesit, në këtë rast fletëvotimi është i vlefshme sepse shenja e dytë edhe pse shihet se është në formë të cilën zakonisht votuesit e bëjnë, mirëpo shikuar më detajisht vërehet se nuk është gjurmë e stilografit por gjurmë e ngjyrës tjetër, atëherë ky fletëvotim është i vlefshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit: 0403X/06D është e shpallur i vlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, edhe pse shihet se një vijë e kuqe është vendosur në rubrikën e subjektit politik me numrin rendor 119 PDK dhe shenja tik tek subjekti politik me numër 112 PDK. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim.

Subjekti politik Nisma – AKR – PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pa vlefshëm sepse të metat apo gabimet të cilat i referohet QNR-ja janë kritere që e bëjnë të pa vlefshëm një fletëvotim.

Paneli, me rastin e vendosjes së ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 0403X/06D duhet të shpallet i pavlefshëm për shkak të mos përmbushjes së kriteve për të qenë e vlefshme e njëjta.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se në rubrikën me numër 112 subjekti politik PDK, ka të shënuar tik-un ndërsa tek rubrika me numër 119 subjekti politik AAK, është e shënuar një vijë e kuqe e cila nuk ka të bëjë me vullnetin e votuesit. Kështu që Paneli ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

Anr. 487/2019 më datën 18.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Kraçiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.